



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.421/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Arsim Hamzaj-anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale për Kryetar të Komunës 2025-Balotazh, të mbajtura me datë 09 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.421/2025, e datës 07.11.2025.

II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale për Kryetar Komune 2025-Balotazh, të mbajtura me datë 09 Nëntor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 2500 euro (dymijepesëqind euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 07.10.2025 ne PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 05.11.2025 rreth orës 15:00, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje! në Prishtinë, kanë vërejtur se: kandidati i subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Prishtinës në zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025, z. Përparim Rama, ka shfrytëzuar pozitën publike të zyrtarit të lartë, Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, z. Samir Shahini dhe institucionin publik shkollën fillore publike me qëllim të fitimit të votave për vete dhe subjektin politik që përfaqëson duke publikuar video në ambientet e brendshme të shkollës, numrin dhe akronimin e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës. Me këtë veprimet e

sipërpërmendura, kandidati i lartcekur dhe subjekti politik LDK, kanë shkelur dispozitat e nenit 36 paragrafi 1 dhe 2, i LZP-së duke përdorur resurset shtetërore të nivelit lokal për qëllime të fitimit të votave. Provë ka bashkangjitur video linku i postimit në Facebook: <https://ëëë.facebook.com/share/v/1D66JËSyHN/> (shih nga sec. 0:38-0:43).

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 08.11.2025, thekson se pas shqyrtimit të plotë të materialit të paraqitur, konstatohet se ky pretendim është i pabazuar si në fakt ashtu edhe në ligj. Videoja në fjalë nuk përmban asnjë element që do të mund të kualifikohej si aktivitet zgjedhor brenda hapësirave shkollës dhe nuk paraqet asnjë thirrje politike apo promovim elektorale. Së pari, duhet theksuar se videoja është realizuar jashtë periudhës zyrtare fushatës balotazh, për çka dëshmojnë rrethanat e qarta veshja e pjesëmarrësve është ambienti paraqitet me ndriçim karakteristik sezonit ngrohtë dhe koha e është e dukshme. Kjo nënkupton se materiali nuk mund konsiderohet pjesë e aktiviteteve fushatës zgjedhore dhe për këtë arsye nuk bie ndesh me Ligjin për Zgjedhje, i cili ndalon shfrytëzimin e objekteve publike vetëm gjatë periudhës së fushatës, sepse fushata zyrtare ka qenë nga 3 deri me 8 nëntor. Së dyti, në video nuk figuron asnjë shenjë identifikuese e shkollës, mbishkrim apo pamje dalluese e ambienteve mësimore. Pamja e paraqitur është një korridor i thjeshtë i cili nuk mund të përdoret si provë për pretendimin e shfrytëzimit të institucionit arsimor për interesa politike. Për më tepër, nuk shfaqet proces mësimor, nxënës apo staf arsimor, çka do të ishte kriter i qartë për konstatimin e ndikimit politik brenda shkollës. Videoja e përmendur është realizuar dhe publikuar më datë 24 shtator 2024, pra shumë përpara fillimit të fushatës së balotazhit. Sipas kalendarit zyrtar zgjedhor, periudha e fushatës së balotazhit ka filluar më 3 nëntor dhe ka përfunduar më 8 nëntor 2025, Kjo do të thotë se çdo pretendim apo interpretim se materiali është prodhuar ose përdorur gjatë fushatës për të ndikuar procesin zgjedhor është i pasaktë dhe nuk përputhet me faktet. Data e publikimit dhe realizimit të videos është e dokumentuar qartë dhe e verifikueshme, përfshirë edhe nëpërmjet fotografive dhe materialeve të bashkangjitura, të cilat dëshmojnë në mënyrë të paanshme kohën dhe rrethanat e xhirimit. Prandaj, është e rëndësishme që debati publik të mbështetet në prova dhe jo në supozime apo keqinterpretim të qëllimshëm. Kjo video nuk lidhet me fushatën e balotazhit dhe nuk është realizuar në atë periudhë, çka e bën të qartë se çdo akuzë ose insinuatë në këtë drejtim është e pabazuar dhe e pavërtetë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë dhe provat e bashkangjitura, vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të subjektit politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, përkatësisht, video linku i postimit në Facebook: <https://ëëë.facebook.com/share/v/1D66JËSyHN/> Paneli vlerëson se nga kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për Komunën e Prishtinës, z. Përparim Rama, më datë 05.11.2025, ka publikuar në profilin e tij zyrtar në Facebook një video, e cila shërben për promovim të subjektit politik LDK për fushatën zgjedhore. Bazuar në këtë i njëjti ka shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që është shfrytëzuar zyrtari publik për qëllime elektorale, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen përcakton se “*Personi i cili mban pozitë publike i*

zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.”

Mbi këtë bazë ligjore Paneli vërteton faktin se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama ka shfrytëzuar pozitën publike të zyrtarit të lartë, Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, z. Samir Shahini gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të përfitimit të votave. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidatit për kryetar të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama, bien ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli i vlerësoi edhe pretendimet nga përgjigja në ankesë *“se në video nuk figuron asnjë shenjë identifikuese e shkollës, mbishkrim apo pamje dalluese e ambienteve mësimore, mirëpo Paneli këtë pretendim e vlerëson si të pabazuar për fatin se pavarësisht se nuk është bërë identifikimi i shkollës me ankesë, megjithatë në këtë video figuron Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, z. Samir Shahini, e të cilën video kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës e ka postuar brenda fushatës zgjedhore të rundit të dytë të zgjedhjeve.*

Lidhur me pretendimin tjetër nga përgjigja në ankesë *“se videoja është realizuar dhe publikuar më datë 24 shtator të vitit 2024, pra shumë kohë përpara fillimit të fushatës së balotazhit”,* të njëjtin pretendim Paneli e vlerëson si të pabazuar për faktin se pavarësisht se kur është realizuar dhe publikuar videoja, megjithatë ajo është publikuar më datë 05.11.2025, në ora 11.00, nga kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës në rrjetin e tij social.

Paneli, me rastin e vendosjes së dënimit me gjobë si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin e mbajtur zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë ka marrë për bazë edhe praktikën e PZAP-it, për rastet të ngjashme të vendosura në PZAP.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr.421/2025, datë 10.11.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në pajtim me nenin 118 paragrafi 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.